

UDHËZIM
Nr. 16, datë 27.8.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 10.7.2023,
“PËR NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË DHE NGARKESËN MËSIMORE TË
PUNONJËSVE ARSIMORË NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “d”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të urdhrit nr. 578, datë 11.11.2025, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit, znj. Orjana Osmani”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 14, datë 10.7.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, të bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

- a) Nën-pika “iii”, e shkronjës “a”, të pikës 2, të kreut II ndryshon, si më poshtë:
“iii. Tri klasa, kur numri i nxënësve është 21–30;”;
- b) Pas nën-pikës “iii”, të shkronjës “a”, të pikës 2, të kreut II shtohet nën-pika “iii/1”, me këtë përmbajtje:
“iii/1. Katër klasa, kur numri i nxënësve për klasë është 31–50;”;
- c) Kudo në pikën 3, të kreut II, togfjalëshi “se 80” zëvendësohet “se 60”;
- ç) Në shkronjën “c”, të pikës 4, të kreut II, pas togfjalëshit “mësuesi në shkollat e arsimit special” shtohet togfjalëshi “mësuesi i artit pamor, mësuesi i edukimit muzikor”;
- d) Pas shkronjës “c”, të pikës 4, të kreut II shtohet shkronja “c/1”, me këtë përmbajtje:
“c/1. Mësuesi i lëndës Edukim fizik dhe sporte: 21 orë në javë”;
- dh) Në pikën 4, të kreut II, pas fjalisë “Drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës e plotësojnë normën mësimore javore vetëm me orë të profilit të diplomës që zotërojnë.”, shtohet paragrafi me përmbajtjen si vijon:
“Drejtori/nëndrejtori i shkollës që është i profilit të arsimit fillor mund ta plotësojë ngarkesën mësimore javore edhe me orë mësimore të përcaktuara në kreun V të këtij udhëzimi”;
- e) Në shkronjën “f”, të pikës 4, të kreut II, togfjalëshi “me 81” zëvendësohet “me 61”;
- ë) Në shkronjën “a”, të pikës 5, të kreut II, togfjalëshi “me 81” zëvendësohet “me 61”;
- f) Shkronja “a”, e pikës 2, të kreut III, ndryshon si më poshtë:
“a) Kur numri i nxënësve është më shumë se 60, emërohet një drejtor shkolle”;
- g) Pas shkronjës “b”, të pikës 3, të kreut III shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:
“b/1. Mësuesi i lëndës Edukim fizik dhe sporte: 21 orë në javë”;
- gj) Në shkronjën “d”, të pikës 3, të kreut III, togfjalëshi “me 81” zëvendësohet “me 61”;
- h) Në shkronjën “a”, të pikës 4, të kreut III, togfjalëshi “me 81” zëvendësohet “me 61”;
- i) Shkronja “a”, e pikës 2, të kreut IV ndryshon si më poshtë:
“a) Kur numri i nxënësve është më shumë se 60, emërohet një drejtor shkolle”;
- j) Në shkronjën “f”, të pikës 3, të kreut IV, pas togfjalëshit “Dega Balet”, të shtohet togfjalëshi:
“, lëndët: Repertor, Teknikë Djem, Puante Vajza, Balet Modern, Valle Popullore, Duet Klasik:”;
- k) Shkronjat “g” dhe “h”, të pikës 3, të kreut IV ndryshojnë, si më poshtë:

- “g) Drejtori i shkollës me 61–200 nxënës: 6 orë në javë.
h) Drejtori i shkollës me 201–600 nxënës: 4 orë në javë”;
- l) Në shkronjën “a”, të pikës 4, të kreut IV, togfjalëshi “me 81” zëvendësohet “me 61”.
- ll) Pas shkronjës “a”, të pikës 6, të kreut IV shtohet shkronja “a/1” me këtë përmbajtje:
“a/1) Orët e lëndës Formim Praktik Profesional për specialitetin “Futboll” ndahen në grupe “Lojtarët” dhe “Portierët”. Grupi i lojtarëve formohet me nxënës të të njëjtit nivel arsimor. Grupi i “Portierëve” formohet me jo më pak se 6 nxënës të të njëjtit nivel arsimor”;
- m) Pika 18 e kreut V shfuqizohet;
- n) Në kreun V, pas pikës 31, shtohen pikat 32, 33 dhe 34 me përmbajtje si më poshtë:
“32. Kryetarit të ekipit lëndor i ulet norma mësimore me 2 orë në javë.
33. Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë e ka normën mësimore 6–10 orë në javë; mësuesi koordinator i këshillimit të karrierës e ka normën mësimore 8–12 orë në javë.
34. Drejtori ose nëndrejtori i ngarkuar me organizimin dhe monitorimin e programit “Pas shkolle”, të ketë ulje në normën mësimore javore në varësi të numrit të grupeve/klubeve, si më poshtë:
a) 2 orë mësimore në javë, kur institucioni ka deri 4 grupe ose klube;
b) 4 orë mësimore në javë, kur institucioni ka mbi 4 grupe ose klube.”.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.
Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
Orjana Osmani